



Metoda Kërkimi

Prof. Asoc. Dr. Ezmolda Barolli



Kapitulli 3

Rishikimi Kritik i Literaturës



Objektivat

- Të kuptoni qëllimin dhe rëndësinë e rishikimit të literaturës
- Të dini se çfarë duhet të përfshini në rishikimin e literaturës
- Të njiheni me burimet primare, sekondare dhe terciare të literaturës
- Të identifikoni fjalët kyçe dhe të realizoni kërkimin duke përdorur një sërë metodash përfshirë dhe Internetin
- Të mund të vlerësoni literaturën që keni gjetur në lidhje me përputhshmërinë dhe relevancën me temën tuaj
- Të dini ti referoheni me saktësi literaturës
- Të dini të aplikoni në të njohuritë dhe aftësitë që keni fituar vetë nga kërkimi që keni bërë



Përmbajtja

1. **Hyrje**
2. **Rishikimi kritik**
3. **Burimet e literaturës**
4. **Planifikimi i strategjisë së kërkimit të literaturës**
5. **Realizimi i kërkimit të literaturës**
6. **Përftimi i literaturës dhe vlerësimi**
7. **Regjistrimi i literaturës**
8. **Përmbledhje**



1. Hyrje

- **Dy arsye kryesore për të cilat bëhet rishikimi i literaturës janë:**
 - Kërkimet paraprake për të gjeneruar dhe rafinuar idetë
 - Rishikimi kritik që është pjesë e punimit përfundimtar, i cili demonstroi njohuritë tuaja për çështjen, kufizimet, dhe vendin që zë punimi juaj në kontekstin më të gjërë të çështjes që trajtoni, dhe ju drejton tek pyetjet e kërimit
- **Vlera e kërimit tuaj do të gjykohet dhe do të krahasohen patjetër me punimet dhe kërkimet e të tjerëve**
- **Proçesi i kërimit është një aktivitet që fillon herët me kërkimin dhe zgjat gjatë gjithë kohës duke kaluar nëpër një spirale derisa ta shkruani si kapitull të plotë**
 - Përcaktimi i paramentrave të pyetjeve dhe objektivave të kërimit
 - Gjenerimi i fjalëve kyçe dhe nisja e kërimit të parë





2. Rishikimi Kritik - Qëllimi

- Krijohet themeli mbi të cilin vendoset kërkimi juaj
- Ju ndihmon të kuptoni kërkimet e mëparëshme në atë fushë dhe tendencat e reja
- Në varësi të metodës së kërkimit varet edhe qëllimi për të cilën lexohet literatura
 - Literatura përdoret për të identifikuar teoritë dhe idetë të cilat testohen duke përdorur të dhënat - metoda **deduktive**
 - Eksplorohen të dhënat dhe zhvillohen teori të cilat më pas lidhen me literaturën – metoda **induktive**
- Nuk është qëllimi të shkruhet një përmbledhje e gjithçkaje që është shkruar në lidhje me temën tuaj, por të rishikohen kërkimet më relevante dhe domethënëse



Rishikimi Kritik – Qëllimi (2)

Gall et al. (2002)

- Të përmirësoni më tej pyetjet dhe objektivat e kërkimit
- Të zbuloni mundësitë e kërkimit që kanë qenë të fshehura
- Të zbuloni rekomandimet për kërkimet e ardhme
- Të shmangni përsëritjen e punimeve të të tjerëve
- Të krahasohen opinionet nëpër literatura të ndryshme për të përfituar ide të reja për pyetjet dhe objektivat
- Të zbulohen metodat, strategjitë dhe teknikat më të përshtatshme për kërkimin tuaj



Rishikimi Kritik – Përmbajtja

- Të vlerësoni kërkimet që janë bërë tashmë në këtë fushë
- Të përfshini teoritë kryesore akademike të fushës
- Të tregoni dhe shpjegoni lidhjet midis gjetjeve të publikuara më parë
- Të referoni literaturën në të cilën janë raportuar ato, duke shmangur plagjarizmin
- Të jepni pikat kyçe dhe tendencat e reja si dhe ti paraqisni në një mënyrë logjike që tregon lidhjen me punimin tuaj
- Të krijoni kufijtë në të cilat shtrihet punimi juaj
- Të jeni kritik për ato që keni lexuar duke argumentuar pse
- Të demonstoni që njohuritë tuaja për këtë fushë janë aktuale



Rishikimi Kritik – Përmbajtja (2)

Vlerësimi i përmbajtjes

- Lidhet qartësisht literatura me pyetjet dhe objektivat?
- Janë paraqitur teoritë më relevante dhe domethënëse të ekspertëve më të njohur?
- Janë paraqitur literaturat më relevante dhe domethënëse , ose të paktën ato më përfaqësueset?
- Keni përfshirë literaturë të përditësuar?
- Janë paraqitur të gjitha referencat e cituara, sipas formatit të përshkruar në kriteret e vlerësimit?



Rishikimi Kritik – Kuptimi

Mingers (2000:255-6) – ka katër aspekte të një trajtimi kritik

- **Kritika e retorikës**

- Përdorim efektiv i gjuhës në vlerësimin e një problemi
- Përdorimi i aftësive për të bërë gjykime të arsyeshme dhe debate efektive në të shkruar

- **Kritika e traditës**

- Kritika ndaj teorive dhe vlerave të mirëqena, të pranuar nga të gjithë

- **Kritika e autoritetit**

- Kritika ndaj ekspertëve të fushës

- **Kritika e objektivitetit**

- Informacioni dhe njohuritë që po diskutoni kanë vlerë



Rishikimi Kritik – Kuptimi (2)

Sipas Dees 2003 duhet:

- Ti referoheni dhe të vlerësoni kërkimet nga ekspertë të njohur në fushën që keni zgjedhur
- Të merrni në konsideratë dhe të diskutoni kërkimet që mbështesin dhe ato që kundërshtojnë idetë tuaja
- Të gjykoni arsyeshëm vlerat e punimeve të të tjerëve dhe të tregoni lidhjen me punimin tuaj
- Të justifikoni argumentat tuaja me evidenca të vlefshme në një mënyrë logjike
- Të dalloni qartë midis fakteve dhe opinioneve

Rishikimi Kritik – Kuptimi (3)

Kriteret e vlerësimit nëse rishikimi është kritik:

- Lidhja e pyetjeve me punimet e rishikuara
- Pikat e forta dhe të dobëta të punimeve të rishikuara
- Diskutime dhe vlerësime objektive për punimet e tjera
- Referenca me punimet e kundërta me idetë tuaja
- Dallimi midis fakteve dhe opinioneve
- Gjykime të arsyeshme për vlerat dhe relevancën e punimeve të të tjerëve
- Justifikime të qarta për idetë
- Identifikimi i fushave ku nevojiten kërkime të reja
 - Mungesë njohurish, paragjykime për kërkimet e mëparëshme, gjetjet duhen testuar, faktet janë të pakta ose kontradiktore
- Justifikimi i argumentave duke referuar korrekt publikimet

Rishikimi Kritik – Struktura

Jankowicz – Rishikimi i Literaturës duhet të jetë një përshkrim dhe analizë kritike e asaj që kanë shkruar autorët e tjerë

Struktura

- Një kapitull
- Disa kapituj
- Gjatë gjithë raportit

Duhet të shihet si një hinkë në të cilën:


- Fillohet në një nivel të gjerë derisa ngushtohet tek pyetjet dhe objektivat
- Jep një pamje të shpejtë të ideve dhe temave kyçe
- Përmbledh, krahason dhe përball kërkimet e kërkuesve të tjerë
- Ngushtohet duke fokusuar punimet që lidhen më shumë me punimin
- Ofron arsye për rezultatet dhe si lidhen ato
- Thekson aspektet ku kërkimi juaj ofron gjëra të reja
- E drejton lexuesin në seksionet në vazhdim ku eksplorohet çështja

Rishikimi Kritik – Struktura (2)

Kriteret e vlerësimit të strukturës:

- Ka një titull të qartë që përshkruan fokusin e kërimit?
- Keni shpjeguar si keni kërkuar në literaturë dhe kriteret që përdorët për të përzgjedhur këtë literaturë?
- Keni filluar nga niveli me i gjerë deri sa ngushtohet?
- Organizohet tematika e rishikimit kritik rreth idesë së kërimit?
- Janë argumentat koherentë dhe kohezivë – lidhen idetë në mënyrë logjike?
- Keni përdorur nënçështje për ta ndihmuar lexuesin?
- A tërheq vëmendjen e lexuesit struktura që keni përdorur drejt çështjeve më të rëndësishme?
- A e drejton kjo pjesë lexuesin në seksionet në vazhdim?

3. Burimet e Literaturës



Saunders *et al.* (2009)



Burimet e Literaturës – (2)

- Kategoritë e ndryshme të literaturës përfaqësojnë rrjedhën e informacionit që nga burimi origjinal
- Nga burimi primar – në sekondar – pastaj terciar informacioni bëhet më pak i detajuar dhe i autorizuar por më lehtësisht i aksesueshëm
- Literatura primare është më e vështirë për tu aksesuar dhe shpesh quhet literatura gri



4. Planifikimi i strategjisë së kërkimit të literaturës

- Shpesh kërkimi i literaturës është një konsumues i madh i kohës dhe një sasi të tepërt informacioni
- Planifikimi dhe ndërtimi i një strategjie kërkimi e bën më të lehtë këtë proces
- Kjo përfshin:
 - Parametrat e kërkimit
 - Fjalët kyçe dhe termat e kërkimit që do të përdoren
 - Bazat e të dhënave dhe motorët e kërkimit që do të përdoren
 - Kriteret që do të përdoren për të përzgjedhur studimet relevante midis gjithë atyre që gjeni



5. Realizimi i kërkimit të literaturës

- **Kjo gjë arrihet duke përdorur një sërë rrugësh:**
 - Kërkimi duke përdorur burimet terciare
 - Marrja e literatursë relevante nga librat dhe revistat që keni lexuar
 - Skanimi dhe shfletimi i literaturës sekondare në bibliotekë
 - Kërkimi duke përdorur Internetin
 - Mund të kombinohen këto mënyra gjatë rrugës
- **Sugjerohet të fillohet me të dytën**
 - Librat mund të mos jenë informacioni më i përditësuar por ofrojnë një pikënisje shumë të mirë për t'ju drejtuar në të tjera literatura



6. Përftimi i literaturës dhe vlerësimi

- **Pas kërkimeve fillestare në libra dhe revista, literatura terciare do t'ju ofrojë detaje se cila literaturë është e disponueshme dhe ku ta gjeni atë**
- **Përfitimi i literaturës:**
 - Shfletoni katalogët e bibliotekave ose Internetin për të gjetur literaturën e kërkuar
 - Skanoni artikujt e plotë
 - Porosisni ose blini vetëm atëherë kur vërtetë ju duhen
- **Vlerësimi i literaturës së përftuar:**
 - Si do ta dimë që literatura që lexojmë është relevante?
 - Si do ta kuptojmë se kemi lexuar mjaftueshëm?

Vlerësimi i literaturës së përftuar

○ **Relevanca**

- Sa aktuale është?
- A ka mundësi të ndryshojë?
- A ka lidhje me pyetjet dhe objektivat e kërkimit për ta përfshirë atë apo për ta përjashtuar?
- Keni parë referenca tek kjo literaturë ose autorin e saj në të tjera botime të vlefshme?
- A i mbështet apo i kundërshton ajo argumentat tuaja?

○ **Vlera**

- A është literatura e lexuar e ndikuar nga emocionet e autorit apo faktorë të tjerë?
- Cilat janë përjashtimet metodologjike (në lidhje me përzgjedhjen e kampionit, mbledhje e të dhënave, analizë)?
- A është saktësia e mjaftueshme?
- A ofron kjo literaturë guidë për kërkime të mëtejshme?



Vlerësimi i literaturës së përftuar

○ Mjaftueshmëria

- A keni cituar autorët më të rëndësishëm të fushës?
- Nqs leximi i mëtejshëm ju dërgon në të njëjtat referenca që i keni lexuar njëherë.
- Konsultohuni me udhëheqësin.



7. Regjistrimi i literaturës

- **Detajet bibliografike (Tabela 3.6)**
 - Sistemi i Harvardit
 - Sistemi American Psychological Association
 - Sistemi Vancouver ose i *footnotes*
- **Përmbledhje e shkurtër**
- **Informacione suplementare (Tabela 3.7)**

Saunders *et al.* (2009)



Plagjarizmi

○ Katër format e zakonshme

- Vjedhja e materialeve nga një burim tjetër
- Përfshirja e materialeve të shkruara nga ndonjë tjetër
- Kopjimi i materialeve pa thonjëza
- Perifrazimi i materialeve pa dokumentim

Përshtatur nga Park (2003), cituar në Easterby-Smith *et al.* (2008)



8. Përmbledhje

- Rishikimi kritik i literaturës ndihmon kërkuesin të kuptojë në thellësi kërkimet e mëparëshme që kanë lidhje me pyetjet dhe objektivat e tij të kërkimit
- Nuk ka një strukturë të paracaktuar por këshillohet të jetë në formën e hinkës duke filluar nga një nivel më i gjerë deri tek pyetjet specifike të kërkimit dhe objektivat
- Burimet e literaturës janë primare, sekondare dhe terciare, kërkimi i të cilave varet nga pyetjet dhe objektivat
- Kur planifikohet kërkimi i literaturës duhet:
 - Të përcaktohen qartësisht pyetjet dhe objektivat
 - Përcaktohen parametrat e kërkimit
 - Gjenerohen fjalët kyçe dhe termat e kërkimit
 - Diskutohen idetë me kolegët dhe udhëheqësin
- Teknikat për të realizuar këtë:
 - Pema e relevancës dhe braninstorming



8. Përmbledhje

- **Kërkimi i literaturës bëhet në disa rrugë:**
 - Kërkim në literaturë terciare dhe Internet
 - Kërkimi sipas referencave të artikujve që keni lexuar
 - Skanimi dhe shfletimi i literaturës sekondare
- **Mbani gjithmonë shënime për procesin që keni përdorur dhe rezultatet**
- **Për të vlerësuar literaturën e përftuar përdoren kritere të qarta vlerësimi**
 - Të konsideroni sa e përdorur është kjo literaturë
 - Regjistroni detajet bibliografike dhe ato shtesë